



**BASHKIA**  
**REPUBLIKË TIRANË SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 51, datë 3.05.2019

**PËR MIRATIMIN E TREGUESVE TË REALIZIMIT TË BUXHETIT  
TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2018**


Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 44, nenit 54 dhe nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"; udhëzimit nr. 22 datë 30.07.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore"; Udhëzimit plotësues nr.2 datë 19.01.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë "Për zbatimin e buxhetit 2018"; si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,


**V E N D O S I:**

1. Miratimin e treguesve të realizimit të buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2018 sipas relacionit, pasqyrave nr.1, nr.2, nr. 3 dhe nr. 4 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të gjitha strukturat e tjera përkatëse të Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Tiranë.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT TIRANË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 19524/ Prot.

Tiranë më 16.5.2019

Lënda: Verifikim ligjshmërie

**KËSHILLIT BASHKIAK TIRANË**

Tiranë

Bazuar në Ligjin nr.107/2016, dt.27.10.2016 « Për Prefektin » dhe Ligjin nr. 139/2015, « Për vetëqeverisjen vendore », Prefekti i Qarkut Tiranë, verifikoi ligjshmërinë e **Vendimeve nr.28,29,30,31,32,33,34,35,36,37,38,39,40,41,42,43,44,45,46,47,48,49,50,51** datë **03.05.2019** të Këshillit të Bashkisë Tiranë.

Për sa më sipër:

**1.Vendimi nr.28 datë 03.05.2019** “Për krijimin e Muzeut Vendor “Shtëpia Studio Kadare”” është në përputhje me ligjin 139/2015, « Për vetëqeverisjen vendore » si dhe me ligjin nr.27/2018 « Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë », ligjin nr.10405 datë 24.3.2011 « Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve » si dhe me VKM-në nr.165 datë 02.03.2016 « Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nënpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore » i ndryshuar.

**2.Vendimi nr.29 datë 03.05.2019** “Për miratimin e projektit “Fillo me një ide- fito një intership në Bashkinë Tiranë “ Thirrja II, hartuar sipas Udhëzuesit operacional për zbatimin e tij” është në përputhje me ligjin nr.139/2015, « Për vetëqeverisjen vendore ».



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT TIRANË  
SEKTORI JURIDIK

**20.Vendimi nr.47 datë 03.05.2019** “Për miratimin e kompensimit ushqimor për fëmijët e familjeve në nevojë në shkollat ku po implementohet projekti pilot “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, nën kujdesin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për periudhën Janar-Shkurt Mars 2019” është në përputhje me ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar, ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë “ i ndryshuar, VKM-në nr.632 datë 04.10.2004 “Për miratimin e dokumentit për politikat e decentralizimit në sektorin e arsimit parauniversitar”, si dhe me VKM-në nr.1071 datë 23.12.2015 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2015-2020 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.

**21.Vendimi nr.48 datë 03.05.2019** “Për krijimin e shoqërisë “Tirana Agrikulturë” sh.p.k si person juridik në pronësi të Bashkisë së Tiranës dhe miratimin e akteve të themelimit” është në përputhje me ligjin 139/2015, « Për vetëqeverisjen vendore « si dhe me ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 « Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare » i ndryshuar.

**22.Vendimi nr.49 datë 03.05.2019** “Për një shtesë dhe disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.159 datë 21.12.2018 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2019-2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019” është në përputhje me ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019” si dhe me ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

**23.Vendimi nr.50 datë 03.05.2019** “Për miratimin e sistemit të fëmijës A.Y dhe z.E.H, person me aftësi të kufizuara, në Institucionin e Përkujdesjes Shoqërore” është në përputhje me ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar si dhe me VKM-në nr.518 datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.

**22.Vendimi nr.51 datë 03.05.2019** “Për miratimin e treguesve të realizimit të buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018” është në përputhje me ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PREFEKTI I QARKUT TIRANË**  
**SEKTORI JURIDIK**

menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe me ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**  
**SUZANA JAHOLLARI**

